



Aplikim për vizë me qëllim kërkimin e një vendi pune (maksimumi deri 6 muaj)

Lutemi të lexoni me kujdes këtë fletë-informacioni dhe formularin e aplikimit dhe përmbajuni saktësisht udhëzimeve.

Aplikimet e plotësuara në mënyrë të mangët apo dokumentacioni i paplotë mund të çojnë në refuzimin e aplikimit. Si pasojë do të nevojitet rezervimi i një date të re aplikimi përfshirë periudhat përkatëse të pritjes.

Për aplikimin ju nevojitet dokumentacioni në formën e përshkruar më poshtë:

1.	Formularë aplikimi për vizë	Në gjermanisht ose anglisht, 2 copë , të plotësuara në mënyrë plotësisht të lexueshme, të nënshkruara personalisht.
2.	Tarifa	Tarifat dhe detyrimet duhet të paguhen kesh në monedhën shqiptare LEK . Tarifa është 75,00 Euro përlogaritur me kursin aktual të këmbimit.
3.	Fotografi pashaporte	3 fotografi identike biometrike për pashaportë, jo më të vjetra se 6 muaj, me sfond të bardhë, madhësia 45x35 mm. Lutemi që në secilin prej dy formularëve të aplikimit të ngjisni nga një fotografi, ndërsa fotografinë e tretë silleni me vete si element të veçantë.
Dokumentat e mëposhtme duhen dorëzuar në origjinal, <u>me 2 fotokopje</u>, në momentin e aplikimit		
4.	Pashaporta e udhëtimit	Me të paktën dy faqe bosh. Lutemi mbani në konsideratë që afati i vlefshmërisë së pashaportës duhet të jetë tre muaj më i gjatë se kohëzgjatja e vizës. Fotokopjoni ju lutem fletën e plastifikuar me të dhënat personale.
5.	Curriculum Vitae	Curriculum Vitae i formuluar nga vetë aplikuesi, duke paraqitur në mënyrë të veçantë kualifikimin dhe eventualisht veprimtarinë profesionale të deritanishme.
6.	Shkresë motivimi	Shkresë motivimi e formuluar nga vetë aplikuesi për kërkimin e vendit të punës të planifikuar. Që këtë duhet të jetë e qartë, se për cilat fusha dhe vende pune interesoheni, ku dëshironi të aplikoni dhe ku do të banoni. Ju lutemi të përmendni edhe njohuritë tuaja të gjuhës gjermane, të sillni dëshminë përkatëse për to dhe – nëse nuk keni njohuri të gjuhës gjermane – të argumentoni përse nuk do të jenë të nevojshme.

7.	Dëshmi kualifikimi	<p>Diplomë e shkollës së lartë gjermane apo e një vendi tjetër e njohur nga Gjermania, apo e krahasueshme me një të tillë.</p> <p>Nëse diploma juaj e shkollës së lartë është e krahasueshme me një diplomë gjermane dhe nëse shkolla e lartë përkatëse njihet si e tillë në Gjermani, këtë mund ta verifikoni në Bazën e të Dhënave ANABIN: http://anabin.kmk.org/ – duhen paraqitur te dy konfirmimet e printuara.</p> <p>Nëse diploma juaj / shkolla e lartë nuk është e regjistruar në këtë Bazë të Dhënash, atëherë duhet të bëni vlerësimin e diplomës suaj nga Zyra Qendrore për Arsimin me Jashtë (ZAB): http://www.kmk.org/zab/zeugnisbewertungen-fuer-auslaendische-hochschulqualifikationen.html</p> <p>Udhëzim: Çertifikatat shqiptare duhet të jenë të pajisura me vulë apostile dhe të përkthyer në gjermanisht</p>
8.	Dëshmi për mundësi të mjaftueshme financimi të gjithë të qëndrimit	<p>Dëshmi e mundësive të financimit për gjithë kohëqëndrimin (shuma minimale e kërkuar 720 euro), ndër të tjera në formën e një deklarate garancie ose përmes derdhjes së shumës përkatëse në një llogari bankare të bllokuar. Për këtë qëllim shihni informacionet përkatëse në faqen e internetit të Ambasadës Gjermane www.tirana.diplo.de</p>
9.	Dëshmi për një siguracion shëndetësor të mjaftueshëm	<p>Dëshmia për siguracionin shëndetësor duhet të lidhet për të gjithë kohëqëndrimin.</p>

Në raste të veçanta, gjatë aplikimit apo procedurës së vizës, mund të kërkohen dokumenta të caktuar të përmendura më sipër.

Klauzolë e përjashtimit nga përgjegjësia:

Të gjitha informacionet e mësipërme përcillen pa garancinë se janë të sakta apo të plota. Ato bazohen në stadin informativ të Ambasadës në momentin e hartimit të tyre.